

VENDIM
Nr.114, datë 28.3.2011

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT PËR TELEVISIONIN PRIVAT
KABLLOR “TV KABLLOR XHAÇI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën televizionit privat kabllor “TV Xhaçi” për zgjerimin e zonës së licencimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV Xhaçi”, sipas licencës nr. 086RTVKABLLOR, në qytetin e Bilishtit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati